

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë

Neni 1

Në Ligjin e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 41/94, 7/97 dhe 21/98), neni 26 ndryshohet dhe thotë:

“Kryqi i kuq realizon mjete financiare nga:

- pagesat e anëtarësimit të anëtarësisë së tij;
- kompensimet e përcaktuara me këtë ligj dhe me një ligj tjetër;
- dhuratat, trashëgimitë dhe legatët;
- kontributet vullnetare;
- qiratë;
- Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxheti i komunave, i qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit;
- donacionet dhe sponsorizimet;
- veprimtaritë që sjellin fitim i cili përdoret për qëllimet dhe detyrat e përcaktuara me Statutin;
- të ardhurat nga investimet, dividendët, interesat dhe kreditë;
- veprimtaritë shërbyese të lidhura me funksionin e Kryqit të kuq; dhe
- mjetet në të holla dhe të ardhurat tjera të përcaktuara me ligj.”

Neni 2

Neni 27 ndryshohet dhe thotë:

“Në dobi të Kryqit të kuq paguhen kompensime, si më poshtë:

- 3% i çmimit të biletës hyrëse për manifestimet kulturore-zbavitëse, koncertet dhe festivalet dhe panairët e karakterit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar, me përjashtim të koncerteve të karakterit humanitar, shfaqjeve teatrore, ekspozitave të pikturave, skulpturave dhe shfaqjeve e ngjarjeve të tjera të organizuara nga nxënësit në shkolla dhe studentët në fakultete;
- 3% i çmimit të çdo bilete hyrës për garat sportive, me përjashtim të sportit amator; dhe
- kompensimi me rastin e regjistrimit të automjeteve.

Baza e pagesës së kompensimit të përmendur në paragrafin 1, alinetë 1 dhe 2 të këtij neni është çmimi i shitjes së biletës hyrëse.

Mjetet e grumbulluara nga paragrafi 1, alinetë 1 dhe 2 të këtij neni, më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së ngjarjes derdhen në llogarinë e Kryqit të kuq.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë me një akt të veçantë përcakton mënyrën e shpërndarjes së mjeteve të grumbulluara nga paragrafi 1 i këtij neni.”

Neni 3

Pas nenit 27 shtohet një nen i ri 27-a, i cili thotë:

“Neni 27-a

Shuma e kompensimit të përmendur në nenin 27 paragrafi 1 alineja 3 të këtij ligji, që mbliidhet për Kryqin e kuq nga personat vendorë juridikë dhe fizikë gjatë regjistrimit të automjeteve, është për:

- 1) Motoçikletat, automjetet me tri rrota dhe automjetet me katër rrota:
 - deri 100 cm³ kompensim prej 15,00 denarë,
 - nga 101 cm³-250 cm³ kompensim prej 20,00 denarë,
 - nga 251 cm³-750 cm³ kompensim prej 40,00 denarë,
 - mbi 751 cm³ kompensim prej 65,00 denarë.
- 2) Automjetet e udhëtarëve
 - deri 33 kW kompensim prej 70,00 denarë,
 - nga 33,1 kW-55 kW kompensim prej 95,00 denarë,
 - nga 55,1 kW-84 kW kompensim prej 110,00 denarë,
 - nga 84,1 kW-150 kW kompensim prej 120,00 denarë,
 - mbi 150 kW kompensim prej 130,00 denarë.
- 3) Automjetet e mallrave
 - ngarkesa deri në 3,5 t kompensim prej 215,00 denarë,
 - ngarkesa nga 3,6 t –10 t kompensim prej 360,00 denarë,
 - ngarkesa mbi 10,1 t kompensim prej 470,00 denarë.
- 4) Automjetet e punës/traktorët
 - kompensim prej 80,00 denarë.
- 5) Autobusët dedikuar për:
 - trafikun ndër-komunal dhe trafikun ndërkombëtar, kompensim prej 330,00 denarë, dhe
 - trafikun urban dhe periferik, kompensim prej 240,00 denarë.
- 6) Automjetet tërheqëse
 - kompensim prej 350,00 denarë.
- 7) Automjetet speciale
 - kompensim prej 80,00 denarë, dhe
- 8) Automjetet lidhëse (të bashkëngjitura)
 - kompensim prej 190,00 denarë.

I obliguar për të paguar kompensimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, është personi juridik ose fizik në emrin e të cilit regjistrohet automjeti.

Kompensimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, nga personi juridik ose fizik në emrin e të cilit regjistrohet automjeti mbliidhet nga personi i autorizuar juridik për kryerjen e kontrollit teknik, me rastin e kryerjes së pagesës për kontrollin teknik, dhe dëshmia bashkëngjitet kur regjistrohet automjeti.

Personi juridik i autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik duhet të derdhë mjetet e mbledhura nga paragrafi 3 i këtij neni, më së voni deri në të 15-tin e muajit të tanishëm për muajin paraprak, në llogarinë e Kryqit të kuq.

Personi juridik që kryen kontrollin teknik i përmendur në paragrafin 3, dorëzon një raport mujor për Kryqin e kuq, i cili përmban të dhëna për numrin e automjeteve sipas kategorive që kanë kryer kontrollin teknik, kompensimin sipas kategorive të automjeteve, si dhe kompensimin e përgjithshëm.”

Neni 4

Neni 28 ndryshohet dhe thotë:

“Gjatë aksioneve dhe manifestimeve tradicionale: “Java e luftës kundër kancerit”, “Java e Kryqit të kuq”, “Java e luftës kundër Sidës”, “Java e luftës kundër sëmundjeve të gjoksit dhe tuberkulozit” dhe “Java e luftës kundër urisë” emetohen pulla postare shtesë. Emetimi, distribucioni, shitja dhe llogaritja e pullave postare shtesë bëhet nga Shoqata Aksionare e Trafikut Postar “Posta e Maqedonisë” në pronësi shtetërore – Shkup, në përputhje me ligjin.

Për kohëzgjatjen e aksioneve dhe manifestimeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, në dobi të Kryqit të kuq paguhet kompensim në shumë prej 30% të vlerës nominale të pullës postare shtesë për letra deri në 20 gram për çdo dërgesë postare në trafikun e brendshëm dhe ndërkombëtar postar, me përjashtim të dërgesave për libra dhe revista.

Kompensimi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhet nga Shoqata Aksionare e Trafikut Postar “Posta e Maqedonisë” në pronësi shtetërore – Shkup dhe nga ofruesit tjerë të shërbimeve postare, në përputhje me ligjin.

Shoqata Aksionare e Trafikut Postar “Posta e Maqedonisë” në pronësi shtetërore – Shkup dhe ofruesit tjerë të shërbimeve postare, mjetet e mbledhura nga kompensimi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së aksionit ose manifestimit i derdhen në llogarinë e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Kryqi i kuq me akt përcakton ditët kur organizohen aksionet dhe manifestimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.”

Neni 5

Neni 30 ndryshohet dhe thotë:

“Mbikëqyrja ndaj kryerjes së detyrimeve të neneve 27, 27-a, 28 dhe 29 të këtij ligji, në lidhje me mbledhjen dhe pagesën e kompensimeve bëhet nga organet kompetente, të cilat kryejnë mbikëqyrjen e punës së subjekteve juridike të përmendura në nenet 27, 27-a, 28 dhe 29 të këtij ligji.”

Neni 6

Neni 34 ndryshohet dhe thotë:

“Një gjobë në shumë prej 3000 euro në kundërvlerë të denarëve do të shqiptohet për personin juridik nëse nuk mbledh dhe nuk kryen pagesën e kompensimeve në dobi të Kryqit të kuq dhe nëse nuk dorëzon një raport mujor për Kryqin e kuq, në përputhje me nenet 27, 27-a dhe 28 të këtij ligji.

Një gjobë në shumë prej 30 për qind të gjobës së matur për personin juridik do të shqiptohet për kundërvajtje për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, dhe për personin përgjegjës në personin juridik.

Një gjobë në shumë prej 100 deri 200 euro në kundërvlerë të denarëve do të shqiptohet për personin zyrtar në personin juridik për veprimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.”

Neni 7

Neni 35 ndryshohet dhe thotë:

“Një gjobë në shumë prej 5000 euro në kundërvlerë të denarëve do të shqiptohet për personin juridik që në mënyrë të paautorizuar përdor emrin e Kryqit të kuq në kundërshtim me nenin 9 të këtij ligji.

Një gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do të shqiptohet për kundërvajtje për veprimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dhe për personin përgjegjës në personin juridik.”

Neni 8

Neni 36 ndryshohet dhe thotë:

“Një gjobë në shumë prej 150 deri 300 euro në kundërvlerë të denarëve do të shqiptohet për kundërvajtje të një personi fizik:

- 1) nëse në një situatë të jashtëzakonshme ose ushtarake mban ose përdor emblemën e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë si emblemë mbrojtëse, dhe nuk ka cilësinë e personit të përmendur në nenin 13 paragrafi 1 i këtij ligji; dhe
- 2) nëse gjatë shërbimit nuk e ka me vete legjitimacionin e përmendur në nenin 15 të këtij ligji, ose nëse nuk e mban shiritin me emblemën e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në mënyrën e përcaktuar ose nëse humb kualifikimin e personit në bazë të të cilit e ka marrë legjitimacionin dhe shiritin, dhe nëse nuk i kthen ato tek organi kompetent (neni 16).”

Neni 9

Pas nenit 36 shtohet një nen i ri 36-a, i cili thotë:

“Neni 36-a

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedura e kundërvajtjes do të kryhet dhe sanksioni për kundërvajtje do të shqiptohet nga gjykata kompetente.”

Neni 10

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë do t'i miratojë në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 11

Autorizohet Komisioni Ligjvënës-Juridik i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për të përcaktuar në tekst të spastruar (të korrigjuar në mënyrë përfundimtare) të Ligjit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.